



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:148137
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05755948

CAP.nr.1331/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Arsim Hamzaj në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit të përmbarimit XH.Lnga P,,, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av.S.K nga P,,, kundër debitorit të përmbarimit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) - Prishtinë, me objekt përmbarimi kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.2519/20, të datës 27.12.2022, me datën **20.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit të përmbarimit XH.L nga P,,, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, PPP.nr.2519/20, i datës 27.12.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.2519/20, të datës 27.12.2022, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) - Prishtinë, të parashtruar kundër urdhrit përmbarimor P.nr.65/20, i datës 31.01.2020, dhe të njëjtin urdhër e ka anuluar, ashtu që e ka refuzuar propozimin për përmbarim.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori Xhevdet Latifi, për shkak të *shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale,*

duke propozuar që të aprovet ankesa si e bazuar dhe të shfuqizohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe të detyrohet debitori që t'ia paguaj kreditorit borxhin sipas propozimit me kamatë ligjore prej 8% nga dita e dorëzimit të propozimit për përmbarim deri në pagesën definitive të tij, apo çështjen ta kthejë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa kreditorit të përmbarimit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori i përmbarimit Xh.L, me datën 03.06.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim, kundër debitorit të përmbarimit Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) - Prishtinë, ndërsa përmbaruesi privat me urdhrin P.nr.2126/2020, të datës 03.06.2020, e ka lejuar ekzekutimin në bazë të dokumentit përmbarimor - Vendimit Administrativ të formës së prerë - ,, Nr.,,-,,, të datës 10.02.2020, të Inspektoratit të Punës, për pagesën e borxhit në shumë prej 2,231.22€, të paraparë më gjerësisht si në dokumentin përmbarimor.

Kundër urdhrin për përmbarim debitori i përmbarimit, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim. Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.2519/20, të datës 27.12.2022, e aprovon si të bazuar prapësimin e debitorit të parashtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.2126/2020, të datës 03.06.2020, dhe të njëjtin urdhër e ka shfuqizuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata ka theksuar se prapësimi i debitorit është i bazuar sepse dokumenti në bazë të cilit është inicuar procedura nuk është i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se në të nuk është specifikuar objekti dhe shumat e përmbushjes së detyrimit. Tutje ka shtuar se përmbaruesi privat ka pasur për obligim që të shqyrtojë propozimin për përmbarim e pastaj të caktojë përmbarimin, andaj në rastin konkret ka vlerësuar se urdhëri përmbarimor është lejuar pa u plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21 dhe 27 të LPP-së. Për mënyrën e vendosjes i është referuar dispozitës së nenit 21, 27 dhe 73 të LPP-së.

Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe

m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditores Gjykata e Apelit i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala debitore me prapësim i është referuar papërshtatshmërisë së dokumentit përmbartimor, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbartim, konform dispozitave ligjore në fuqi, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret dokumenti përmbartimor është i papërshtatshëm për përmbartime edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftëse në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Me shikim në shkresat e lëndës konstatohet se dokumenti përmbartimor -Vendimi administrativ i Inspektoratit të Punës, ,, Nr.,-,,,, të datës 10.02.2020, i njëjti në dispozitiv nuk e ***përmban shumën e detyrimit***, e që nuk dihet se si do të ekzekutohet një vendim i tillë. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se qëndrojnë pretendimet prapësuese të debitorit në lidhje me papërshtatshmërinë e përmbartueshmërisë së dokumentit përmbartimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, andaj për Gjykatën e Apelit gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes pati parasysh pretendimet e palës kreditore se *me rastin e ankesës është parashtruar edhe korigjimi i vendimit dhe arsyeja e mosparaqitjes me propozim është se i njëjti është nxjerrur më pas*, mirëpo të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara, për shkak se me shikim në shkresat e lëndës vërtetohet se me rastin e parashtrimit dhe lejimit të propozimit për përmbartim i njëjti është lejuar në bazë të vendimit ,, Nr.,-,,,, të datës 20.01.2020, i cili nuk i ka plotësuar kushtet ligjore për tu konsideruar dokument i rregullt përmbartimor, dhe fakti se tani është bërë korigjimi i këtij vendimi kjo nuk ndikon në ndryshimin e vendimit. Duke i vlerësuar të gjitha pretendimet, gjykata ka vlerësuar se pala kreditore gjatë procedurës nuk ka propozuar plotësimin e propozimit përmbartimor, por vetëm ka bashkangjitur korigjimin e vendimit, andaj dhe gjykata e shkallës së parë sipas prapësimitsë debitorit ka qenë e detyruar që të veprojë konform dispozitave ligjore dhe me të drejtë ka vendosur pasi që nuk ka pasur njohuri lidhur me korigjimin e vendimit përmbartimor. Eventualisht pala kreditore mund të parashtrojë propozim të ri në bazë të vendimit i cili i plotëson kushtet për tu konsideruar dokument i rregullt përmbartimor.

Po ashtu, kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të

mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *”Në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1331/23 datë 20.05.2024

Gjyqtari
Arsim Hamzaj